



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës për informacion, regjistruar me numër rendor 31 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 6061 prot., datë 20.11.2023, në të cilën kërkonti qëndrimin e KLGJ-së mbi pretendimet e ngritura ndaj gjyqtares znj. {...} nga ana e shtetasit z. {...}, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me periudhën për të cilën ngrihen pretendime dhe për rrjedhojë kërkonti qëndrim nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju informojmë se organizimi dhe funksionimi i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte i ndryshëm nga KLD e krijuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe Ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001.

Organizimi i mbledhjeve plenare në ato vite, zhvillohej në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë, institucione këto të cilat përgatisnin dokumentacionin që shqyrtohej në të, për rrjedhojë edhe vendimet përkatëse.

Gjithashtu, sqarojmë se, për periudhën që ju kërkonti informacion, më konkretisht për vitin 1996, për znj. {...}, emëruar me Vendimin nr. 14, datë 21.12.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtare pranë Gjykatës Fier, bazuar në Regjistrin Themeltar të Ministrisë së Drejtësisë, që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton se:

1. Me Vendimin nr. 7, datë 08.02.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është liruar nga detyra për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës.
2. Me Vendimin nr. 8, datë 23.08.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës Mallakastër.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!